



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 648/19 prot.

Elbasan, më 12.03 2022

VENDIM

Nr. 16 datë, 12/03 /2022

"Mbi miratimin e kuotave të pranimit, në programet e studimit të ciklit të dytë, për vitin akademik 2022-2023"

Bazuar në Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, neni 25, pika 7; neni 37, pikat 1 dhe 2, neni 38, pika 1, dhe pika 3, në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, pika 2.7, germa a,b,c, në statutin e UE-së "A. Xhuvani" neni 9, germa h, si dhe në Vendimin nr.10, datë 10.03.2022 të Senati Akademik të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" "Mbi miratimin e kuotave të pranimit, në programet e studimit të ciklit të dytë, për vitin akademik 2022-2023", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 12.03.2022

V E N D O S I :

1. Të miratojë kuotat e pranimit në Universitetin e Elbasanit "A. Xhuvani" për vitin akademik 2022-2023, në programet e studimit ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave", me kohë të plotë (tabela 2 bashkëlidhur), gjithsej **666 kuota** si më poshtë vijon:
 - a) Kuotat e pranimit për kandidatë studentë brenda vendit: **572 kuota**.
 - b) Kuota e pranimit për kandidatë studentë nga trojet: **10 kuota**.
 - c) Kuota e pranimit për kandidatët studentë nga kategoritë e veçanta (me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët studentë romë dhe ballkano egjiptianë): **2 kuota**.
 - d) Kuotat e pranimeve për kandidatët studentë që aplikojnë për transferim studimesh: **6 kuota**
 - e) Kuotat e pranimit për kandidatët studentë që aplikojnë për një program të dytë studimi: **76 kuota**.

2. Të miratojë kuotat e pranimi në Universitetin e Elbasanit “A. Xhuvani” për vitin akademik 2022-2023, në programet e studimit ciklit të dytë të studimeve “Master profesional”, me kohë të plotë (tabela 3 bashkëlidhur), gjithsej **1223 kuota** të ndarë si më poshtë vijon:
- a) Kuotat e pranimi për kandidatë studentë brenda vendit: **1164 kuota.**
 - b) Kuota e pranimi për kandidatë studentë nga trojet: **8 kuota.**
 - c) Kuota e pranimi për kandidatët studentë nga kategoritë e veçanta (me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët studentë romë dhe ballkano egjiptianë): **6 kuota.**
 - d) Kuotat e pranimeve për kandidatët studentë që aplikojnë për transferim studimesh: **5 kuota**
 - e) Kuotat e pranimi për kandidatët studentë që aplikojnë për një program të dytë studimi: **40 kuota.**
3. Kuotat e përcaktuara të pikave 1/b; 1/c; 1/d; 1/e; dhe të pikave 2/b, 2/c, 2d ,2/e, do të shpërndahen nga Rektorati sipas kërkesave të njësisë kryesore të UE-së.
4. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ardian DURMISHI

